

Lidhja Nr. 9
Formulari i aplikimit për pranimin në shërbimin e MZSH-së

Udhëzime

1. Plotësoni çdo kuti në këtë aplikim në mënyrë të plotë. Një aplikim jo i plotë mund t`ju skualifikojë nga procesi i përzgjedhjes.
2. Përgjigjuni çdo pyetje duke thënë vetëm të vërtetën. Përgjigjet e rreme do t`ju skualifikojnë automatikisht.
3. Plotësoni informacionin e kërkuar me stilolaps. Në rast se shkrimi nuk është i kuptueshëm, ju mund të skualifikoheni.
4. Nëse një pyetje nuk aplikohet në rastin tuaj, ju lutemi plotësoni kutinë përkatëse, duke shkruar “N/A” (nuk aplikohet).
5. Aplikimet e plotësuara duhet të dorëzohen bashkë me kopjen e dëftesës së shkollës së mesme ose diplomës së lartë, si dhe një kopje të lejes suaj për drejtimi automjeti pranë Drejtorisë së Personelit dhe Burimeve Njërezore.

1. INFORMACION PERSONAL

| | | | | | |
|--|-------|---|-----------------|--|---|
| Mbiemri : | | Emri : | | Atësia : | |
| Adresa : | | | Nr. i telefonit | | Adresa e email-it |
| Datëlindja : | Mosha | Vendlindja: | Gjatësia | Pesha: | Gjinia : Mashkull <input type="checkbox"/> Femër <input type="checkbox"/> |
| Data/muaji/viti | | | | | |
| Gjendja civile Martuar <input type="checkbox"/> I/e ve <input type="checkbox"/> Beqar <input type="checkbox"/> Ndarë <input type="checkbox"/> Divorcuar <input type="checkbox"/> | | Jeni shtetas shqiptar ? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> | | Keni leje drejtimi të kategorisë “B” apo me sipër ? Po <input type="checkbox"/> Nr. i lejes së Drejtitimit : Jo <input type="checkbox"/> | |

Keni të afërm të punësuar aktivishtë në Shërbimin Zjarrëfiks?

| | | | | | |
|---|------|--------|--------------------|--|------------------------|
| Po <input type="checkbox"/> Nëse “PO” , plotësoni informacionin e mëposhtëm | | | | | |
| Jo <input type="checkbox"/> | | | | | |
| Mbiemri | Emri | Atësia | Lidhja që ka me ju | Grada&Pozicioni në shërbimin e MZSH-së | Vendi ku kryen detyrën |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

Firma e aplikantit

2. **BANESAT** (Rendisni adresat në të cilat keni banuar gjatë 10 viteve të fundit. Filloni me adresën ku jetoni aktualisht. Përfshini edhe adresa ku keni jetuar përkohësisht.)

| | | | |
|---------------------|----------------------|----------|--------------------|
| Nga : Muaji/viti | Deri : Aktualisht | Adresa : | |
| Nga : Muaji/viti | Deri : Aktualisht | Adresa : | Arsyeja e largimit |
| Nga : Muaji/viti | Deri : Aktualisht | Adresa : | Arsyeja e largimit |
| Nga : Muaji/viti | Deri : Aktualisht | Adresa : | Arsyeja e largimit |

3. **ARSIMI** (Shkollat e mesme që keni ndjekur. Rendisni shkollën e fundit që keni ndjekur të parën)

| Emri i shkollës | Fshati/Qyteti | Periudha kohore | Diplomuar |
|-----------------|---------------|-----------------|--|
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> |
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> |
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> |

Universitet që keni ndjekur (Rendisni universitetin e fundit që keni ndjekur të parin)

| Emri i universitetit | Qyteti | Periudha kohore | Diplomuar | Diplomuar për | Specialiteti |
|----------------------|--------|-----------------|--|---------------|--------------|
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> | | |
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> | | |
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> | | |

Shkolla profesionale që keni ndjekur (Rendisni shkollën që keni ndjekur të parën)

| Emri i universitetit | Qyteti | Periudha kohore | Diplomuar | Specialiteti |
|----------------------|--------|-----------------|--|--------------|
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> | |
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> | |
| | | | Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> | |

Firma e aplikantit

4. PËRVOJA E PUNËS (Rendisni punën tuaj të fundit të parën)

| Data | Emri i punëdhënësit | Adresa & Nr. i telefonit | Pozicioni | Arsyeja e largimit |
|--------------------------|---------------------------|--------------------------|-----------|--------------------|
| Nga : Data/muaji/viti | Deri : Data/muaji/viti | | | |
| Nga : Data/muaji/viti | Deri : Data/muaji/viti | | | |
| Nga : Data/muaji/viti | Deri : Data/muaji/viti | | | |
| Nga : Data/muaji/viti | Deri : Data/muaji/viti | | | |

5. SHËRBIMI USHTARAK (Keni shërbyer ndonjëherë në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë ?)

| | | | |
|--|--------------------------------|--------------------------|---------------------------|
| Po <input type="checkbox"/> Nëse "PO", plotësoni informacionin e mëposhtëm | | | |
| Jo <input type="checkbox"/> | | | |
| Forcat në të cilën keni shërbyer | | Periudha kohore | Vendndodhja |
| Toksore <input type="checkbox"/> | Garda <input type="checkbox"/> | Nga : Data/muaji/viti | Deri : Data/muaji/viti |
| Detare <input type="checkbox"/> | | | |
| Ajrore <input type="checkbox"/> | | | |

6. VEPRIMTARIA KRIMINALE

Jeni dënuar ndonjëherë për ndonjë krim?

| | | | |
|--|----------------|-------------|---------|
| Po <input type="checkbox"/> Nëse "PO", plotësoni informacionin e mëposhtëm | | | |
| Jo <input type="checkbox"/> | | | |
| Lloji i krimit | Data e dënimit | Vendndodhja | Gjykata |
| | | | |

Jeni arratisur ndonjëherë për një krim, panvarsisht nëse nuk jeni dënuar?

| | | |
|--|-------------------|-------------|
| Po <input type="checkbox"/> Nëse "PO", plotësoni informacionin e mëposhtëm | | |
| Jo <input type="checkbox"/> | | |
| Lloji i krimit | Data e arrestimit | Vendndodhja |
| | | |

Jeni dënuar ndonjëherë kur keni qënë i mitur?

| | | |
|--|----------------|-------------|
| Po <input type="checkbox"/> Nëse "PO", plotësoni informacionin e mëposhtëm | | |
| Jo <input type="checkbox"/> | | |
| Lloji i krimit | Data e dënimit | Vendndodhja |
| | | |

Firma e aplikantit

A jeni aktualisht nën ndjekje penale apo prisni që kjo të fillojë së shpejti?

| | | |
|-----------------------------|---|-------------|
| Po <input type="checkbox"/> | Nëse "PO" , plotësoni informacionin e mëposhtëm | |
| Jo <input type="checkbox"/> | | |
| Lloji i krimit | Data e dënimit | Vendndodhja |
| | | |

7. GJUHË TË HUAJA (Rendisni të gjitha gjuhët e huaja që njihni)

| Gjuha | Lexon | | Shkruan | | Flet | | Kupton | |
|-------|----------------------------------|--------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
| | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> |
| | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> |
| | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> |
| | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> |
| | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> | Sh.mirë <input type="checkbox"/> | Mirë <input type="checkbox"/> |
| | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> | Disi <input type="checkbox"/> | Dobët <input type="checkbox"/> |

8. REFERENCAT

Rendisni emrat e tre personave që ju kanë njohur gjatë 5 viteve të fubdit. (Mos përfshini emrat e personave që janë përmëndurmë sipër në këtë formular aplikimi)

| Mbiemri | Emri | Atësia | Adresa & Nr.i telefonit |
|---------|------|--------|-------------------------|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Firma e aplikantit

PROCEDURAT E PRANIMIT NË SHËRBIMIN ZJARRFIKËS

Kriteret për pranimin e kandidatëve

1. Kandidati për pranim në nivelin bazë të shërbimit vendor të MZSH-së duhet të plotësojë këto kritere:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- d) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- e) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- f) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- g) Të mos ndiqet nga organet e policies dhe të prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policies dhe prokurorisë);
- h) Të jetë i/e moshës nën 30 vjeç;
- i) Të kalojë testimin fizik, teorik (nga komisioni i ngritur në çdo njësi vendore dhe me përfaqësues nga Drejtoria e MZSH-së);
- j) Të jetë me vendbanim pranë stacionit të MZSH-së ku do të shërbejë;
- k) Për gjininë mashkullore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 170 cm;
- l) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 160 cm;
- m) Të jetë me peshë trupore që ti përgjigjet raportit të gjatësisë;
- n) Kandidati për personelin shofer të MZSH-së, duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi “D”, si dhe me leje të veçantë drejtimi, konformë Kodit Rrugor;
- o) Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesionet si mekanik, shofer, hidraulik, karpentier, infermier, elektrikist, etj.

2. Kandidati për pranimin në nivelin e mesëm duhet të plotësojë këto kritere :

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë përfunduar arsimin e lartë policor, ushtarak, juridik ose inxhinjeri, niveli minimal i diplomës “Bachelor”;
- c) Për nevoja të shërbimit, në sektorë të veçantë, në nivelin e mesëm, përveç arsimit të lartë të përcaktuar në pikëb, të pikes 2, pranohen edhe kandidat nga fakultete të tjera;
- d) Për sektorin e inspektim – parandalimit, preferohet të pranohen kandidat që kanë përfunduar fakultetet e inxhinjeri , juridik ose arsim policor;
- e) Për sektorin e ndërhyrjes, preferohet të pranohen kandidat me arsim ushtarak dhe policor;
- f) Për sektorin e mbështetjes dhe logjistikës, preferohen të pranohen kandidat me arsim finance dhe ekonomik;
- g) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- h) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike;
- i) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e vepre penale me dashje;

3. Kandidati për pranimin në nivelin e lartë duhet të plotësojë këto kritere :
 - a) Në këtë nivel konkurojnë dhe pranohen ata persona që plotësojnë kërkesat e pikes 2, të këtij neni;
 - b) Të ketë punuar në nivelin e mesëm në strukturat e shërbimit MZSH-së jo më pak se 10 vjet dhe të mbajë gradën maksimale të nivelit të mesëm.
4. Për funksionet e nivelit të mesëm dhe të lartë, Kryetari i Bashkisë, sipas kritereve të sipërcituara i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, jo më pak se tre kandidatura, për një vend vakant.
5. Për nivelin madhor konkurojnë ata persona që plotësojnë kërkesat e pikes 3, të këtij neni, që kanë punuar në nivelin e lartë të shërbimit të MZSH-së jo më pak se 10 vjet dhe që mbajnë gradën maksimale për nivelin e lartë.

Procedurat e aplikimit

1. Strukturat e burimeve njërezore në Bashki, për punonjësit vendor të MZSH-së së bashku me drejtorin/shefin e sektorit vendor të shërbimit të MZSH-së, sipas nevojave të shërbimit, nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë, shpall periudhën e aplikimit, programin e konkurimit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, fazat e konkurimit si dhe kuotat e pranimit për kandidatët që do të vazhdojnë kursin e trajnimit për pranim në shërbimin zjarrfikës.

2. Njoftimi për kriteret, kohën, rregullat dhe procedurën e aplikimit, realizohet nëpërmjet njoftimeve në mediat vizive dhe të shkruara lokale, ose njoftimeve website e Bashkisë.

3. Aplikantëve u jepet formulary i aplikimit (Lidhja Nr. 9), si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për procedurat, kërkesat dhe specifikimet për çdo lloj testi e verifikimi.

4. Aplikantët plotësojnë formularin dhe e dorëzojnë në bashkë me dokumentacionin e kërkuar në strukturat e burimeve njërezore të Bashkisë, ku aplikanti ka vendbanimin e përhershëm.

5. Strukturat e burimeve njërezore në Bashki përgatit udhëzuesin e aplikimit, i cili publikohet në website-in e Bashkisë dhe duhet të përmbajë informacion për :

- a) Kriteret e domosdoshme për përzgjedhjen e aplikantit;
- b) Procedurat e aplikimit;
- c) Procedurat e testimit, metodat dhe standartet;
- d) Misionin, synimet dhe përgjegjësit e shërbimit zjarrfikës;
- e) Kushtet e punës, paga dhe përfitimet;

Dokumentacioni i aplikimit

Aplikanti paraqet në strukturat përkatëse të burimeve njërezore dokumentacionin e mëposhtëm :

- a) Formularin e aplikimit;
- b) Fotokopje të kartës së identitetit;
- c) Document zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;
- d) Fotokopje e dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “B”;
- e) Çertifikat e gjendjes gjyqësore;
- f) Çertifikat familjare;

- g) Vërtetim nga gjykata;
- h) Vërtetim nga prokuroria;
- i) Raport mjeko – ligjor;
- j) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim që ndjek arsimin e lartë (nëse i disponon);
- k) Document të lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

Verifikimi i të dhënave të aplikantit dhe procedurat e përzgjedhjes.

1. Strukturat vendore e MZSH-së së bashku me atë të burimeve njërëzore të Bashkisë shqyrton formularin e aplikimit, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti, për të verifikuar nëse ai plotëson kriteret e përcaktuara në ligj.
2. Strukturat e burimeve njërëzore të Bashkisë, nëpërmjet strukturave të hetimit të krimit bëjnë verifikimin paraprak të aplikantëve për rekorde të mundshme kriminale.
3. Në përfundim të procesit të verifikimit hartohet lista emërore e aplikantëve që plotësojnë kriteret dhe çdo aplikant pajiset me një formular pranimit për testim (lidhja Nr. 10), duke i caktuar një numër kodik identifikimi, i cili vendoset në të gjithë formularët dhe dokumentacionin që përdoret deri në përfundim të procesit të pranimit.
4. Aplikanti që rezulton se nuk plotëson kriteret e përcaktuara në ligj, skualifikohet.
5. Strukturat vendore të burimeve njërëzore e Bashkisë njoftojnë me shkrim aplikantin që nuk kualifikohet
6. Aplikanti ka të drejtën e ankimit.
7. Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit, verifikimit dhe ankimit të aplikantëve përcaktohen me procedure standarte.

Njoftim për konkurim

Strukturat e burimeve njërëzore të Bashkisë, publikojnë në website-in e Bashkisë dhe në median e shkruar locale, datën, orën dhe vendin e zhvillimit të konkurimit, si dhe listen e kandidatëve që kualifikohen për të konkuruar

Faza e konkurimit

1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së, i nënshtrohet fazave të konkurimit sipas rendit të mëposhtëm :
 - a) Testim me shkrim;
 - b) Testim të aftësive fizike;
 - c) Intervistë me gojë;
 - d) Testim psikologjik;
 - e) Verifikim përfundimtar i aplikantit.
2. Për zhvillimin e konkurimit, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, ngrihet komisioni përkatës, i cili është përherë me numër tek. Në përbërje të komisionit duhet të jenë 2 (dy) punonjës të shërbimit përkatës vendor të MZSH-së nga funksionet drejtor/shef i sektorit vendor

të MZSH-së, instruktor i stërvitjes, inspektor i parandalimit ose punonjës të MZSH-së me eksperiencë, 1 (një) punonjës nga strukturat e burimeve njërzore të Bashkisë dhe 2 (dy) punonjës nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së.

3. Në përfundim të konkurimit, komisioni mban process – verbal përkatës (lidhja Nr. 11), i cili do t'i bashkëngjitet urdhërit të drejtorit/shefit të MZSH-së për emërimin në detyrë të punonjësit.

Testimi me shkrim

1. Testi me shkrim hartohet nga strukturat e burimeve njërzore të Bashkisë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të arsimit ose kompani të licënuara për këtë qëllim. Testi shërben për të vlerësuar, nëse aplikanti zotëron njohurit dhe aftësit e nevojshme për të kryer detyrë punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantit i kërkohet të lexojë, të shkruajë, të analizojë dhe të kuptojë gjuhën standarte shqipe. Testi me shkrim administrohet dhe vlerësohet me pike nga komisioni i testimit. Në përfundim të testit me shkrim, struktura e burimeve njërzore publikon zyrtarisht listen e renditjes së rezultateve të testit. Për aplikantët për nivelin e mesëm, testi me shkrim, krahas të tjerash, përmban edhe njohuri mbi legjislacionin, veçanërisht mbi atë të shërbimit zjarrfikës.

2. Aplikantët që kanë marrë 60% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, njoftohen për të vazhduar procesin e testimit. Rezultatet e testit me shkrim ruhen në dosjen e aplikantit dhe përbëjnë 50% të rezultatit të përgjithshëm të tij.

3. Aplikantët që nuk arrijnë 60% të pikëve të nevojshme të testit me shkrim kanë të drejtë të riaplikojnë për t'u pranuar në shërbimin e MZSH-së, me shpalljen e rathës së vendeve të lira.

Testi i aftësive fizike

1. Aplikantët që kjojnë testin me shkrim, duhet të kalojnë testin e aftësive fizike, që teston aftësit psikomotore, ku përfshihen : shpejtësiaq, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së.

2. Strukturat e shërbimit vendor të MZSH-së, duhet të sigurojnë dhe të parapregatisin kushtet, për realizimin e testimit.

3. Testi i aftësive fizike vlerësohet sipas standartit të përcaktuar në kohën e zhvillimit të testit.

4. Testi fizik përmban vlerësimin e peshës dhe gjatësisë trupore, testin e vrapimit dhe testin e përgjithshëm të muskujve.

a) Vlerësimi i peshës dhe i gjatësisë trupore;

b) Në këtë vlerësim bëhen matjet fizike të gjatësisë dhe të peshës së aplikantit. Koeficienti i masës trupore është tregues që jep raportin e peshës së njëriut në kg, pjesuar me dyfishin e gjatësisë trupore të tij në metra. $Pra K = \frac{pasha}{(në\ kg)} \div pjesuar\ 2 \times gjatësia\ në\ metra$.

Shëmbull : Për një person me peshë 90kg dhe me gjatësi 1,80 m koeficienti i indeksit të masës trupore është $90kg / (2 \times 1.80) = 25$. Standarti i koeficientit të masës trupore është në kufijtë 20 – 26. Forma më e mire fizike dhe shëndetsore është koeficienti 23.

c) Testi i përgatitjes fizike përmban ; kapërcimin e parabolës, vrapim 2400 m dhe 300 m, pompa për krahët (ulje – ngritje, si dhe ushtrime për muskujt e barkut (palosje).

d) Vlerësimi për çdo komponent sipas moshës dhe gjinisë bëhet sipas normave të përcaktuara në këtë rregullore.

Rregullat dhe kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike

1. Rregullat dhe kriteret për kalimin e testit të aftësive fizike janë si më poshtë:

a) Aplikanti duhet të paraqiten në datën e testimit me uniformë të rregullt sportive. Nuk janë të lejuara mjete të cilat mund të krijojnë avantazhe gjatë testimit. Nuk lejohet gjithashtu, përveç rasteve kur specifikohet nga mjeku, veshja e mjeteve si dorashka, rripa të trashë mes, fashë elastike ose gjunjëza dhe varëse, të cilat mund të shkaktojnë dëmtim të individit gjatë testimit. Mjetet elektronike si MP3 player, radio, telefona celular apo bipera nuk janë të lejuara gjithashtu. Fermat duhet të heqin vathët gjatë zhvillimit të testit pasi kjo mund të shkaktojë dëmtim për ato.

b) Vendi i testimit duhet të jetë i sheshtë dhe të mos ketë pengesa të çdolloji që mund të ndikojnë negativisht në formën sportive të aplikantit që testohet. Vendi i testimit duhet të përfshijë:

c) Aplikanti duhet t`i kalojë të gjitha fazat e testimit fizik në rendin e kërkuar.

d) Pikët maksimale të përcaktuara për këtë test janë 100. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

2. Pas përfundimit të testit, kandidatit i bëhet i ditur rezultati dhe nëse ka kaluar njoftohet për të vazhduar procesin e testimit.

Intervista me gojë

1. Qëllimet e intervistës me gojë janë të vlerësojë :

a) Aftësitë e kandidatit për të menduar, analizuar, komunikuar dhe marrë vendimesipas nivelit për të cilin aplikon;

b) Aftësitë e komandantit për të reaguuar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

c) Përshtatshërinë e kandidatit për t`u bërë punonjës i shërbimit të MZSH-së.

Zhvillimi i intervistës

1. Komisioni i ngritur me urdhë të Kryetarit të Bashkisë i bën aplikantit pyetje të strukturuar, të cilat nuk kërkojnë njohuri paraprake të teknikave apo praktikave të shërbimit të MZSH-së. Pyetjet testojnë aftësitë e aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe konceptesi dhe për të analizuar dhe marrë vendime.

2. Komisioni e kryen intervistë me gojë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara dhe vendos për secilin aplikant rezultatin numerik, bazuar në një mekanizëm të miratuar vlerësimi.

Mesatarja e vlerësimeve individuale të secilit antar të komisionit përbën 50% të rezultatit të përgjithshëm të kandidatit.

Kontrolli psikologjik

Kandidatët e përzgjedhur i nënshtrohen kontrollit psikologjik, nga psikolog të licencuar, për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre nga pikëpamja psikologjike për të kryer detyra me rrezik të shtuar të shërbimit të MZSH-së.

Përcaktimi i listës me rezultatet e konkurimit

1. Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testit me shrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%;

2. Aplikantët renditen në listen pëfundimtare sipas rezultateve të arritura. Kjo listë shpallet publikisht jo më vonë se të nesmen e ditës së përfundimit të procesit të intervistimit me gojë.

Menaxhimi i procesit të konkurimit

1. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të pranimit është/shefi i MZSH-së dhe drejtori/ sektori i burimeve njërzore të Bashkisë;

2. Struktura përgjegjëse për kryerjen e testimit me shkrim, testimit fizik, testimit psikologjik dhe intervistës me gojë është drejtorja/ sektori i MZSH-së së Bashkisë;

3. Struktura përgjegjëse për verifikimin përfundimtar të aplikantit është struktura e burimeve njërzore të Bashkisë.

Rastet e skualifikimit

- a) Nuk kalon testin me shkrim;
- b) Nuk kalon testin e aftësive fizike;
- c) Nuk kalon testin psikologjik;
- d) Ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të fallcifikuar;
- e) Rezulton përdorues drogeapo të ketë varësi nga alkooli.

Publikimi i rezultateve të kandidatëve

Në përfundim të procesit të konkurimit, drejtorja/ sektori i burimeve njërzore publikon, në website-in e Bashkisë, listen e rezultateve përfundimtare sipas rendit zbritës dhe fituesit që do të ndjekin procedurat e mëtejshme për pranimin në shërbimin e MZSH-së

Pranimi në shërbimin e MZSH-së

1. Kandidati ikualifikuar për pranim në shërbimin e MZSH-së , të nivelit bazë, i nënshtrohet testimit fiziko – professional dhe kursit përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra trajnimi zjarrfikës;

2. Me pëfundimin e kursit të trajnimit dhe testimit përkatës, kandidatit për punonjës, i nivelit bazë, të MZSH-së i jepet grada “Asistent zjarrfikës” dhe emërohet në detyrë me urdhër të drejtorit/shefit të shërbimit vendor të MZSH-së, ndërsa kandidati për nivelin e mesëm i jepet grada “Inspektor zjarrfikës” dhe emërohet në detyrë nga Drejtori i Përgjithshëm I MZSH-së me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Kontrata e punës

1. Punonjësi i shërbimit vendor të MZSH-së në momentin e pranimit nëshërbimin zjarrfikës nënshkruan një kontrat individuale të punës midis tij dhe Kryetarit të Bashkisë;

2. Kontrta individuale e punës përmban :

- a) Identitetin e palëve;
- b) Vendin e punës;
- c) Përshkrimin e përgjithshëm të punës;
- d) Datën e fillimit të punës;
- e) Kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës;
- f) Kohëzgjatja e pushimit vjetor;
- g) Elementët përbërës të pages; dhe datën e dhënies së saj;
- h) Kohën minimale javore të punës